



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Indeksi i Çmimeve të Prodhimit TM4-2016**



## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikoj Indeksin e çmimeve të prodhimit (IÇP) nga muaji Maj 2009.

Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më ndikim në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor i referohen vitit 2007, ndërsa nga tremujori i parë i vitit 2009, është duke u bërë monitorimi dhe llogaritja e indeksit në vazhdimësi, në periudha tremujore dhe vjetore.

IÇP - Indeksi i çmimeve të prodhimit është në përputhshmëri me Klasifikimin Standard të Veprimtarive sipas NACE rev.2, bazuar në "Reregulloren Nr.11/2013 neni 7 për implementimin e standartit për klasifikimin e veprimtarive" IÇP është në zhvillim e sipër dhe synon të përfshijë në vazhdimësi aktivitete ekonomike të cilat për momentin nuk janë aktive, por, gradualisht pritet prodhimi nga këto aktivitete.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: [economic@ks-gov.net](mailto:economic@ks-gov.net).

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtori i Departamentit  
Ibish Asllani - Shef divizionit  
Hamdi Jupolli - Shef Sektori  
Hasan Berisha-Zyrtar i lartë

Mars, 2016

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,  
Isa Krasniqi

### **Simbolet dhe Shkurtesat**

IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NVE	-	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
TM1	-	Tremujori i parë
TM2	-	Tremujori i dytë
TM3	-	Tremujori i tretë
TM4	-	Tremujori i katërt

:	-	Shfra nuk është disponibël
0	-	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	-	Nuk aplikohet
%	-	Përqindje
W	-	Ponderët statistikor (pesha specifike)
∅	-	Mesatare

## **Përmbajtja**

	Faqe
Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e katërt - 2016 .....	4
Tabela 1: Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) TM1 2009 – TM4 2016 (2010=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje .....	5
Tabela 2: Peshat, indeksi i çmimeve të prodhimit (2010=100) dhe ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje .....	7
Metodologjia .....	8

## **Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e Katërt - 2016**

Indeksi i tërsishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë pësoj rënie për -0.1% mes të TM3 2016 dhe TM4 2016. Krahasuar me TM4 2015 çmimet e prodhimit u ulen në një mesatare prej -0.1%.

### **Tremujori i Tretë 2016 – Tremujori i Katërt 2016 -0.1%**

Çmimet e prodhimit në Kosovë pësuan rënie prej -0.1%, në mes të TM3 2016 dhe TM4 2016. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vrehen te: prodhimi i paisjeve elektrike (-3.7%), prodhimi i produkteve ushqimore (-1.6%), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar (-1.6%), prodhimi i produkteve kimike (-0.9%), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gëshetuara – thurëse (-0.6%), produkteve minerale jometalike (-0.5%) prodhimi i mobiljeve (-0.4%), prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0.3%), grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (-0.2%) dhe prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (-0.1%).

Rënia u neutralizua me ngritjen e çmimeve te: nxjerrja e xehes së metalit (44.8%), prodhimi i metaleve (2.0%), prodhimi i pijeve (0.5%) dhe prodhimi produkteve të gomës dhe të plastikës (0.3%).

### **Tremujori i Katërt 2015 - Tremujori i Katërt 2016 -0.1%**


Çmimet e Prodhimit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej -0.1 % në mes të TM4 2015 dhe TM4 2016. Rënie sipas degeve të veprimtarive të ekonomike vrehen te: prodhimi i mjeteve motorike (të transportit) rimorkiove dhe gjysem rimorkiove (-12.9%), prodhimi i produkteve minerale jometalike (-6.7%), prodhimi i produkteve ushqimore (-3.3%), prodhimi i mobiljeve (-2.6%), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gëshetuara – thurëse (-1.8%) prodhimi produkteve kimike (-1.4%), prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (-1.0%), prodhimi i paisjeve elektrike (-0.9%), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-0.7%), xeheroret dhe guroret tjera (-0.7%) dhe prodhimi i pijeve (-0.5%).

Rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: nxjerrja e xehes së metalit (76.3%), prodhimi i metaleve (7.4%), prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (1.2%), grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (1.1%), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar (0.8%) dhe prodhimi produkteve të gomës dhe të plastikës (0.5%).

**Tabela 1: Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) TM1 2009 – TM4 2016 (2010=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje**

Viti	Tremujori	Index (2010=100)	Ndryshimi tremujor në (%)	Ndryshimi vjetor në (%)
2009	TM1	94.9	:	:
	TM2	96.5	1.7	:
	TM3	96.5	0.0	:
	TM4	96.6	0.1	:
	<b>Mesatarja vjetore 2009</b>	<b>96.1</b>	:	:
2010	TM1	97.1	0.5	2.3
	TM2	98.0	0.9	1.6
	TM3	101.1	3.2	4.8
	TM4	103.9	2.8	7.6
	<b>Mesatarja vjetore 2010</b>	<b>100.0</b>	:	<b>4.1</b>
2011	TM1	105.2	1.3	8.3
	TM2	104.5	-0.7	6.6
	TM3	104.4	-0.1	3.3
	TM4	104.2	-0.2	0.3
	<b>Mesatarja vjetore 2011</b>	<b>104.6</b>	:	<b>4.5</b>
2012	TM1	104.6	0.4	-0.6
	TM2	105.8	1.2	1.2
	TM3	107.1	2.4	2.6
	TM4	108.8	1.6	4.4
	<b>Mesatarja vjetore 2012</b>	<b>106.6</b>	:	<b>1.9</b>
2013	TM1	111.3	2.3	6.4
	TM2	109.3	-1.8	3.3
	TM3	106.9	-2.2	-0.2
	TM4	109.0	2.0	0.2
	<b>Mesatarja vjetore 2013</b>	<b>109.1</b>	:	<b>2.4</b>
2014	TM1	109.8	0.7	-1.3
	TM2	109.5	-0.3	0.2
	TM3	110.8	1.2	3.6
	TM4	113.5	2.4	4.1
	<b>Mesatarja vjetore 2014</b>	<b>110.9</b>	:	<b>1.7</b>
2015	TM1	113.7	0.2	3.6
	TM2	114.1	0.4	4.2
	TM3	113.8	-0.3	2.7
	TM4	113.8	0.0	0.3
	<b>Mesatarja vjetore 2015</b>	<b>113.9</b>	:	<b>2.7</b>
2016	TM1	113.2	-0.5	-0.4
	TM2	114.4	1.1	0.3
	TM3	113.8	-0.5	0.0
	TM4	113.7	-0.1	-0.1
	<b>Mesatarja vjetore 2016</b>	<b>113.8</b>	:	<b>-0.1</b>

**Grafiku1: Zhvillimi i IÇP, tremujori i parë 2009 – tremujori i katërt 2016 (2010=100)**



**Tabela 2: Peshat, indeksi i çmimeve të prodhimit (2010=100) dhe ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje**

Kodet	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike rev.2	NVE	Peshat	TM4 - 2016	TM4 - 2016	TM4 - 2016
				Ø2010=100	TM3 - 2016	TM4 - 2015
	<b>Gjithsej IÇP</b>		<b>999.98</b>	<b>113.7</b>	<b>-0.1</b>	<b>-0.1</b>
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve		4.24	137.5	0.0	0.0
07	Nxjerrja e xehes së metalit		14.94	226.9	44.8	76.3
08	Xehedorët dhe guroret tjera		28.63	132.1	0.0	-0.7
10	Përpunimi i produkteve ushqimore		187.68	104.6	-1.6	-3.3
11	Prodhimi i pijeve		89.02	104.6	0.5	-0.5
13	Prodhimi i tekstilit		11.44	0.0	0.0	0.0
14	Prodhimi i veshjeve		4.88	0.0	0.0	0.0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës		2.02	102.5	0.0	-0.7
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gëshetuara - thurëse		12.85	97.9	-0.6	-1.8
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës		14.42	79.8	0.0	0.0
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara		13.15	0.0	0.0	0.0
20	Prodhimi i produkteve kimike		21.14	139.1	-0.9	-1.4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike		0.47	0.0	0.0	0.0
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës		52.12	99.7	0.3	0.5
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike		108.94	92.9	-0.5	-6.7
24	Prodhimi i metaleve		2.16	75.6	2.0	7.4
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve		67.16	91.1	-0.3	1.2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike		4.17	94.8	-3.7	-0.9
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t		1.94	86.4	-0.1	-1.0
30	Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove		0.93	117.3	0.0	-12.9
31	Prodhimi i mobilieve		22.32	94.2	-0.4	-2.6
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar		297.20	131.3	-1.6	0.8
36	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë		21.17	104.4	-0.2	1.1
38	Veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve		16.99	0.0	0.0	0.0



## Definicioni dhe qëllimi i IÇP

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) është tregues relativ që mat shkallën në të cilën çmimet e mallrave (prodhimeve) të prodhuara dhe shërbimeve ndryshojnë në periudha të caktuara kohore.

Kryesisht si parametër statistikor ka një rëndësi të veçantë si deflator i Bruto Prodhimit Vendor me qasjen e prodhimit.

## Metodologjia

Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më reprezentative në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor janë  $TM_1$  për vitin 2007, ndërsa nga  $TM_1$  për vitin 2009 bëhet grumbullimi i rregullt në kontinuitet për çdo tremujor.

Për shkak të krahasueshmërisë së të dhënave me të dhënat e Eurostatit, me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës që nga 01/09/2014 ka filluar të përdorë nomenklaturën e re të aktiviteteve ekonomike (NACE Rev.2) bazuar në “Rregulloren Nr.11/2013 për implementimin e standartit për klasifikimin e veprimtarive” kështu që edhe Indeksi i çmimeve të prodhimit ka pësuar ndryshime në përputhje me këtë nomenklaturë.

Njëherit edhe Indeksi bazë ka pësuar ndryshime duke kaluar nga viti bazë 2007=100 në vitin bazë **2010=100**. Në llogaritjen e këtij indeksi nuk merrin pjesë Ndarjet 13, 14, 18, 21 dhe 38 marrin pjesë në llogaritjen e Indeksit, por për shkak se çmimet për keto Ndarje kanë filluar të grumbullohen pas vitit 2010 dhe u mungon indeksi bazë 2010=100 e qe me vonë do t'u krijohet indeksi bazë dhe do të llogariten edhe këta indikatorë.

Që nga viti 2016, IÇP është i llogaritur për 24 Ndarje (aktivitete ekonomike), rreth 180 ndërmarrje prodhuese me rreth 600 artikuj. Si projekt (GOPA - ASK) ka filluar gjatë vitit 2007 me qëllim që të krijohet baza elementare për themelimin e hulumtimit të IÇP-se, ndërsa nga mesi i vitit 2010 projekti është duke u mbështetur nga SIDA suedeze.

IÇP nga tremujori i parë 2016 përdorë peshat specifike të rifreskuara nga të dhënat e Anketës Strukturore të Bizneseve (ASN), viti 2014.

Për llogaritjen e IÇP-se është përdorë formula e Lasperit

Agregimi deri në IÇP në tërësi

$$PPI_0^q = 100 * \sum_{g=1}^h w_g * I_{0,g}^q$$

$PPI_0^q$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit në mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

$w_g$  = Pesha për grupe

$I_{0,g}^m$  = Shkalla e çmimit për grupin g mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

$h$  = Numri i aktiviteteve ekonomike sipas NACE Rev2.

Llogaritja e indeksit zingjiror të IÇPI

$PPI_{2010}^{Y,q}$  = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2010 dhe tremujorit q në vitin aktual

$PPI_{2010}^{Y-1,q}$  = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2010 dhe tremujorit të katërt në vitin paraprak

$PPI_0^{Y,q}$  = Indeksi i Çmimit të prodhimit mes tremujorit 0 dhe tremujorit q në vitin aktual

### Llogartija e ndryshimeve

Ndryshimi në mes tremujorit q dhe tremujorit q-1 është kalkuluar si vijon:

$$\left[ \left( \frac{PPI_0^{Y,q}}{PPI_0^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Përqindja e ndryshimit tremujor}$$

$PPI_0^{Y,q}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin aktual q

$PPI_0^{Y,q-1}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin paraprak q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si :

$$\left[ \left( \frac{PPI_{2010}^{Y,q}}{PPI_{2010}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Përqindja e ndryshimit vjetor}$$

$PPI_{2010}^{Y,q}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për tremujorin aktual q

$PPI_{2010}^{Y-1,q}$  = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për vitin dhe tremujorin paraprak q

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka ketë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rrgjisrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-qov.net](mailto:infoask@rks-qov.net)
- Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>